



Përmbledhje e qasjeve për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor

Autore: **Marija Luçiq-Çatiq**, Eksperte e jashtme e RNR-së

Radicalisation Awareness Network

RANI 
Practitioners

Përmbledhje e qasjeve për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor

NJOFTIM LIGJOR

Ky dokument është përgatitur për Komisionin Evropian, por i njëjti pasqyron pikëpamjet vetëm të autorit, dhe Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për çfarëdo pasoje të mundshme që mund të gjenerohet nga ripërdorimi i këtij botimi. Më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian mund të gjeni në faqen e internetit (<http://www.europa.eu>)

Luksemburg: Zyra e publikimeve e Bashkimit Evropian, 2023

© Bashkimi Evropian, 2023



Politika e ripërdorimit të dokumenteve të Komisionit Evropian zbatohet me Vendimin e Komisionit 2011/833/BE të 12 dhjetorit 2011 për ripërdorimin e dokumenteve të Komisionit (Gazeta Zyrtare L 330, 14.12.2011, f. 39). Nëse nuk parashihet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti është autorizuar sipas licencës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC-BY 4.0) <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>. Kjo do të thotë se përdorimi ose ripërdorimi lejohet me kusht që të përmendet autori dhe të tregohen ndryshmet e mundshme.

Lidhur me përdorimin ose riprodhimin e elementeve të cilat nuk janë në pronësi të Bashkimit Evropian, do të duhet të kërkohet leje drejtpërdrejtë nga mbajtësit e të drejtave përkatëse.

Hyrje

Në vitet e fundit, prevalenca e gjuhës së urrejtjes është bërë një shqetësim në rritje në shoqëritë evropiane për shkak të efektit të saj dëmtoes në vetë themelin e shoqërisë dhe besimin midis komuniteteve.

Ekspertët dhe praktikuesit kanë ofruar një sërë përkufizimesh të gjuhës së urrejtjes ⁽¹⁾. Për qëllimin e këtij punimi, ne do të përdorim përkufizimin nga Rekomandimi i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) i Këshillit të Evropës që e përkufizoi gjuhën e urrejtjes si:

“avokimi, promovimi ose nxitja, në çfarëdo forme, e denigrimit, urrejtjes ose fyerjes së një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim në lidhje me një person ose grup të tillë personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes, në bazë të 'racës', ngjyrës, prejardhjes, origjinës kombëtare ose etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë ose besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale ose statusit” ⁽²⁾.

Në Ballkanin Perëndimor (BP), narrativat e urrejtjes janë veçanërisht të rrezikshme për shkak të potencialit të tyre thelbësor për të rritur tensionet ekzistuese midis komuniteteve dhe për të ndikuar negativisht në procesin e ndërtimit të besimit, si dhe në rimëkëmbjen e vërtetë të të gjithë shoqërisë nga konfliktet e kaluara. Manifestimi i gjuhës së urrejtjes është evident në të gjitha fushat e realitetit të BP-së. Mesazhet e urrejtjes mund të gjenden në ueb, në media dhe në manifestime kulturore dhe në mjedise urbane dhe rurale, etnikisht homogjene dhe heterogjene.

Trashëgimia e luftërave në vitet e 1990-ta, mungesa e konsensusit mbi narrativat e së kaluarës, fragmentimi ekzistues i shoqërisë, dominimi i identiteteve kolektive, problemet e rëndësishme ekonomike, ndikimet e ndryshme të huaja, normat e forta patriarkale dhe mediat që përhapin intolerancën (dhe urrejtjen) në baza ditore, të gjitha kontribuojnë në pranimin e narrativave të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes si 'normale' në shoqëritë e BP-së. Ky normalizim i gjuhës së urrejtjes rrjedhimisht kontribuon që BP-ja të jetë një terren pjellor për radikalizimin që çon në ekstremizëm të dhunshëm, pasi përdorimi i gjuhës së urrejtjes është një pikënisje e shpeshtë për radikalizimin. Përdoret nga grupet radikale dhe ato të skajshme si gjeneratori kryesor i klimës shoqërore të intolerancës dhe paragjykimëve që shfaqet si një kornizë e përgjithshme psikologjike për zgjerimin e të gjitha formave të akteve të urrejtjes nga dhuna fizike deri te abuzimi verbal dhe psikologjik ⁽³⁾.

Dinamika e gjuhës së urrejtjes në BP është komplekse dhe e shumëanshme:

- Në përgjithësi, gjuha e urrejtjes synon kryesisht anëtarët e grupeve të cënueshme/minoriteteve (LGBTQI+, refugjatët, romët, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe migrantët) ⁽⁴⁾, por në BP përdoret gjithashtu për të nxitur tensionet e vjetra midis grupeve të ndryshme etnike, kombëtare dhe fetare. Edhe pse grupe të ndryshme etnike, kombëtare dhe fetare në vendet e BP nuk njihen si grupe të cënueshme/minoritare me ligj, në realitet, ato shpesh janë të tilla, si p.sh. qytetarët që kthehen në BP, e që ishin larguar nga vendet e tyre gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë. Në një pasqyrë rajonale në kuadër të një raporti të monitorimit mediatik të gjuhës së urrejtjes, u kuptua se në BP “tre kategori u identifikuan si objektivi kryesor i gjuhës së urrejtjes: përkatësia etnike, identiteti gjinor dhe seksualiteti” dhe gjithashtu raporti vuri në dukje se: “Përkatësia etnike është kategoria më problematike, sipas gjetjeve të hulumtimit. Rastet e gjuhës së urrejtjes që synonin përkatësinë etnike

⁽¹⁾ Shih: Rekomandimi i Këshillit të Evropës Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi "gjuhën e urrejtjes" i disponueshëm këtu: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=0900001680505d5b dhe Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së nr. 9/09 për luftimin e krimeve të urrejtjes i datës 2 dhjetor 2009 i disponueshëm këtu: <https://www.osce.org/cio/40695>

⁽²⁾ Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës. (2016). *Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t nr. 15 për luftën kundër gjuhës së urrejtjes*. <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/recommendation-no.15> (fq. 3)

⁽³⁾ Kambovski, V., Georgieva, L., dhe Trajanovski, N. (2020). *Qasjet kombëtare ndaj ekstremizmit. Maqedonia e Veriut*. Instituti Evropian i Mesdheut. https://h2020connekt.eu/wp-content/uploads/2021/01/North-Macedonia_CONNEKT_Approaches_to_extremism.pdf

⁽⁴⁾ OHCHR. (23 mars 2021). *Raport: Po rritet urrejtja në internet kundër pakicave, thotë eksperti*. <https://www.ohchr.org/en/stories/2021/03/report-online-hate-increasing-against-minorities-says-expert>

ishin shpesh të lidhura me luftën e viteve të 90-ta, incidentet kundër migrantëve dhe refugjatëve dhe situatën aktuale politike” (5).

- Nëse (keq)përdoret nga figura politike, kjo "e normalizon drejtpërdrejt dhe e përforcon urrejtjen dhe dhunën në shoqëri" (6). Siç thuhet në rezultatet e hulumtimit të projektit RESILIENCE mbi "Narrativat e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi": "Në shumë raste, narrativat e urrejtjes janë qartësisht të orkestruara politikisht dhe kryesisht shpërndahen përmes mediave të lidhura me partitë kryesore politike. Megjithëse narrativat e urrejtjes të identifikuar në hulumtim nuk janë të reja, ato tani janë normalizuar në një masë shumë të madhe. Në vend që të dënohen vazhdimisht, ato shpesh instrumentalizohen për fushata politike dhe shihen gjithnjë e më shumë si pjesë e rregullt e diskutimit publik." (7).
- Deklaratat politike me urrejtje mund të çojnë në radikalizim reciprok. "Radikalizimi reciprok (dhe termat e lidhur, duke përfshirë ekstremizmin kumulativ dhe bashkë-radikalizimin) është ideja që grupet ekstremiste nxisin retorikën dhe/ose veprimet e njëri-tjetrit, duke përfshirë dhunën" (8). Për shembull, narrivat më të zakonshme të urrejtjes të përdorura ndaj kundërshtarëve politikë në BP (dhe Turqi) ishin se ata janë: armiq të shtetit/popullit, mercenarë të huaj, të rrezikshëm dhe të korruptuar (9). Këto narrativa nixisin retorikën dhe/ose veprimet e njëri-tjetrit që çojnë në rritje graduale të radikalizimit në të dyja anët e kësaj ndarjeje.
- Mediat janë shpesh gjeneruese të gjuhës së urrejtjes dhe të narrativave të urrejtjes: Ka një sërë mënyrash dhe arsyes se si dhe pse mediat marrin pjesë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes, të tilla si mungesa e standardeve profesionale në raportim, transmetimi i mesazheve të urrejtjes pa qëndrim kritik, përdorimi i informacionit të rremë/dezinformatave/informacionit të dëmshëm, karremi për klikime (clickbait) dhe nxitësit e urrejtjes (hate bait) si model biznesi, etj. Informacioni i rremë/dezinformatat/informacioni i dëmshëm, karremi për klikime (clickbait) dhe nxitësit e urrejtjes janë fenomene të ndërlidhura, por të dallueshme, me zona të caktuara të mbivendosjes me gjuhën e urrejtjes. Ato mund të përdoren lehtësisht për përhapjen e gjuhës së urrejtjes që është qartë e dukshme nga përkufizimet e tyre të paraqitura në Tabelën 1.

(5) Shinkoviq, N. (2022). *Raporti i monitorimit mediatik për gjuhën e urrejtjes: Pasqyrë rajonale*. Reporting Diversity Network 2.0. <https://www.reportingdiversity.org/media-monitoring-reports-hate-speech-in-the-balkans-mainly-targets-ethnicity-gender-and-sexual-orientation/>

(6) Parlamenti Evropian, rezoluta e Parlamentit Evropian e 25 tetorit 2018 mbi rritjen e dhunës neofashiste në Evropë (2018/2869(RSP)), P8_TA(2018)0428, Strasburg, 2018. https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2018-0428_EN.html

(7) RESILIENCE. (2021). *Narrivat e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Gjetjet kryesore të hulumtimit*. SEENPM. <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2021/09/Research-2-PDF.pdf>

(8) Hulumtimi i radikalizimit. (3 shtator 2018). *Takime informuese: Radikalizimi reciprok*. <https://www.radicalisationresearch.org/research/briefings-reciprocal-radicalisation/?it=debate/briefings-reciprocal-radicalisation/>

(9) "Armiq të shtetit/popullit (Shqipëri, BdheH [Bosnje dhe Hercegovinë], Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Turqi), p.sh. synojnë destabilizimin, punojnë kundër interesave të vendit, tradhtarë.

Mercenarë të huaj (Shqipëri, BdheH, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Kosovë), p.sh. ithtarë të agjendës ruse dhe serbe (në Mal të Zi), perëndimore ose të Xhorxh Sorosit (Kjo e fundit më së shumti në Maqedoninë e Veriut).

Të rrezikshëm dhe të korruptuar (Shqipëri, BdheH, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Turqi, Kosovë), p.sh. jostabilë, primitivë, nxitës të dhunës, të pafe, parazitë, hajdutë dhe renegatë, gënjeshtarë, të papërgjegjshëm, grupim për koronavirusin (në Maq. të Veriut), kriminelë, qyqarë, hipokritë dhe manipulues (në Shqipëri), të sëmurë mendore (BdheH). RESILIENCE (2021): <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2021/09/Research-2-PDF.pdf>

Tabela 1: Informacioni i rremë/dezinformatat/informacioni i dëmshëm, karremi për klikime (clickbait) dhe nxitësit e urrejtjes

Informacioni i rremë ⁽¹⁰⁾	Informacioni i rremë ⁽¹¹⁾	Informacioni i dëmshëm ⁽¹²⁾	Karremi për klikime (clickbait) ⁽¹³⁾	Ngacmimi ose tallja e qëllimshme ⁽¹⁴⁾
“Informacioni i rremë është informacioni që është i rremë, por personi që e shpërndan atë beson se është i vërtetë.”	“Dezinformatat janë informatat që janë të rreme, por personi që e shpërndan atë e di se është i rremë.” Është një gënjeshtër e paramenduar, e qëllimshme dhe tregon se njerëzit dezinformohen në mënyrë aktive nga aktorë keqdashës.”	Informacioni i dëmshëm është informacion “që bazohet në realitet, por përdoret për të shkaktuar dëme ndaj një personi, organizate ose vendi”.	Diçka (si një titull) që është krijuar për t'i bërë lexuesit të dëshirojnë të klikojnë në një hiperlidhje (hyperlink), veçanërisht kur lidhja çon në përmbajtje me vlerë ose interes të dyshimtë.	Të persekutosh ose irritosh me sulme të padrejta, dashakeqe ose të vazhdueshme (ngacmimi ose tallja e qëllimshme e grupeve të pakicave). Të përpiqesh të zemërosh dikë me kritika ose fyerje. (Ngacmimi ose tallja e qëllimshme e një politikani gjatë një debati.)

Roli i mediave në gjenerimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes në BP njihet në shumë raporte. Siç thuhet në raportin e RESILIENCE 'Narrativat e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi' në strategjitë narrative të ekspozuara si në media ashtu edhe në përmbajtjen e përdoruesve, mund të gjenden tipare të qarta të fashizmit, kryesisht racizmi, nacionalizmi, intoleranca ndaj dallimeve dhe mizogjia ⁽¹⁵⁾. Narrativat e urrejtjes nuk janë raste të izoluara të individëve të veçantë, por rezultate të fushatave të sajura që përdorin metoda të ndryshme, të tilla si raportimi i njëanshëm, keqinformimi/dezinformimi dhe përhapja e frikës ⁽¹⁶⁾. Madje edhe kur mediat kryesore nuk prodhojnë vetë narrativa të gjuhës së urrejtjes, ato bëhen një mjet për t'i përcjellë ato ⁽¹⁷⁾. Në fund, mediat gjithashtu luajnë një rol negativ kur ato dështojnë (për shkak të mungesës së burimeve dhe/ose mungesës së vullnetit) të merren në mënyrë adekuate me ato komente të përdoruesve në të cilat narrativat e urrejtjes përshkallëzohen veçanërisht ⁽¹⁸⁾.

- Gjuha e urrejtjes dhe narrivat e urrejtjes përdoren për të mobilizuar mbështetjen për ideologjitë nacionaliste dhe përjashtuese që synojnë grupe të veçanta etnike ose fetare dhe për të çnjerëzuar dhe delegitimuar këto grupe, duke i bërë ato të cenueshme ndaj diskriminimit dhe dhunës.
- Gjuha e urrejtjes në BP kontribuon në vazhdimësinë e diskriminimit dhe dhunës kundër grupeve të synuara, e gjithashtu mund të radikalizojë shoqërinë në një mënyrë që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm.

Prandaj, reagimi ndaj gjuhës së urrejtjes, duke marrë parasysh kompleksitetin e fenomenit, duhet të jetë shumëplanësh dhe shumësektorial. Përpjekjet e aktorëve institucionalë duhet të plotësohen me punën e

⁽¹⁰⁾ UNESCO. (2018). *Gazetaria, lajmet e rreme dhe dezinformatat: Doracak për edukimin dhe trajnimin në gazetari*. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000265552>

⁽¹¹⁾ Po aty.

⁽¹²⁾ Po aty.

⁽¹³⁾ Fjalori Merriam-Webster: <https://www.merriam-webster.com/dictionary/clickbait>

⁽¹⁴⁾ Fjalori Merriam-Webster: <https://www.merriam-webster.com/dictionary/bait>

⁽¹⁵⁾ Hërvatin, S. B., Petković, B., dhe Hoxhiq, S. (2021). *Narrativat e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Pasqyrë rajonale*. Instituti i Paqes dhe SEENPM. <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2021/03/Regional-overview-Resilience-research-2.pdf> (fq. 22)

⁽¹⁶⁾ Sokol, A. (2021). *Narrativat e urrejtjes në media dhe përmbajtjet e krijuara nga përdoruesit*. SEENPM, Instituti i Paqes dhe Fondacioni Mediacentar Sarajevë. <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2020/12/Resilience-research-publication-2-BiH-English.pdf> (fq. 20)

⁽¹⁷⁾ Londo, I. (2021). *Narrativat e urrejtjes dhe dezinformatat në mediat online në Shqipëri*. SEENPM, Instituti i Paqes dhe Fondacioni Mediacentar Sarajevë. <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2021/01/Resilience-research-publication-2-Albania-English.pdf> (fq. 23)

⁽¹⁸⁾ RESILIENCE. (2021). *Narrativat e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi*. Instituti i Paqes dhe SEENPM. <https://www.mirovni-institut.si/wp-content/uploads/2021/03/E-book-Resilience-research-2-without-KOS-corr-3-March-2021.pdf> (fq. 21)

aktorëve të tjerë, si organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të). Ky punim synon të sistematizojë rolin aktual të OSHC-ve në luftimin e gjuhës së urrejtjes në BP, të krijojë kufizime në punën e tyre dhe të diskutojë drejtimit e mundshme për veprimet që janë të realizueshme dhe të qëndrueshme.

Pas një prezantimi të shkurtër të aktorëve kryesorë institucionalë që janë përgjegjës për luftimin e gjuhës së urrejtjes në të gjitha vendet e BP-së, do të shtjellohet roli i OSHC-ve (roli aktual, kufizimet dhe potenciali). Punimi përfundon me një përmbledhje të drejtimeve të mëtejshme të mundshme të veprimit dhe me rekomandime të politikave.

Aktorët kryesorë institucionalë që luftojnë gjuhën e urrejtjes në BP

Aktorët kryesorë institucionalë të përfshirë në luftimin e gjuhës së urrejtjes në të gjitha vendet e BP-së janë policia dhe gjyqësori. Edhe pse të gjitha vendet e BP-së miratuan dispozita përkatëse në kuadrin e tyre ligjor që mundësonin sanksionimin e gjuhës së urrejtjes nga policia dhe/ose gjykatat, ekziston një mospërputhje e madhe në numrat e rasteve të regjistruara *kundrejt* rasteve të ndjekura penalisht që theksohet në një sërë mjetesh ⁽¹⁹⁾ dhe ⁽²⁰⁾ raportesh monitorimi. Për më tepër, siç thuhet në raportin e RESILIENCE ‘Narrativat e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi’: “Në të gjithë rajonin, ka një hezitim brenda gjyqësorit për të procesuar gjuhën diskriminuese dhe të urrejtjes dhe për ta konsideruar urrejtjen ndaj grupeve të caktuara shoqërore si një faktor përkeqësues në veprat penale” ⁽²¹⁾. Këto gjetje çojnë në përfundimin se ato mekanizma mund të mos jenë të mjaftueshëm, veçanërisht duke pasur parasysh se ato kryesisht reagojnë pasi gjuha e urrejtjes të jetë kryer pa fokus të mjaftueshëm në parandalimin.

Përveç policisë dhe gjyqësorit, ka organe të tjera të ndryshme që veprojnë në parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes:

- Organet e barazisë të krijuara nga Direktiva për Barazinë Racore (2000/43/EC) ⁽²²⁾
 - Një pjesë thelbësore e kompetencës së organit të barazisë është të ofrojë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit, duke përfshirë ngacmimin dhe gjuhën e urrejtjes. Në përputhje me Rekomandimin e Komisionit Evropian për standardet për organet e barazisë, në lidhje me Rekomandimet e Politikave të Përgjithshme të ECRI-t (GPR) nr. 2, ekzistojnë dy lloje të këtyre organeve: organet e barazisë që kanë atributet e një tribunali dhe organet e barazisë që janë të një lloji promovues ⁽²³⁾. Organet e barazisë që kanë atributet e një tribunali mund të: marrin, studiojnë, diskutojnë dhe bashkërendojnë ankesat individuale dhe kolektive dhe t'i gjykojnë

⁽¹⁹⁾ Shih raportin e ODIHR-it: <https://hatecrime.osce.org/infocus/2021-hate-crime-data-now-available>

⁽²⁰⁾ Shih: Hysa, D., dhe Lani, K. (2022). Raport monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Shqipëri. Instituti Shqiptar i Medias. <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2022/07/Monitoring-Report-on-Hate-Speech-in-Albania-12072022.pdf>;

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. (2021). Vendimi nr. 217, i datës 15.11.2021: [https://kmd.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim-nr.-217-date-15.11.2021-Ceshtje-kryesisht-nga-Komisioneri-ne-lidhje-me-gjuhen-e-pedorur-kunder-personave-LGBTI-Diskriminim_Gjuhe-urrejtje.pdf](https://kmd.al/wp-content/uploads/2022/01/Vendim-nr.-217-date-15.11.2021-Ceshtje-kryesisht-nga-Komisioneri-ne-lidhje-me-gjuhen-e-perdorur-kunder-personave-LGBTI-Diskriminim_Gjuhe-urrejtje.pdf);

Raporti vjetor mbi rezultatet e aktiviteteve të Institucionit të Ombudsmanit për të Drejtat e Njeriut të Bosnjës dhe Hercegovinës për vitin 2021. https://www.ombudsmen.gov.ba/documents/obudsmen_doc2022041413104027bos.pdf;

Raporti i Komisionit Evropian mbi Bosnjën dhe Hercegovinën për vitin 2022: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Bosnia%20and%20Herzegovina%20Report%202022.pdf>;

Raporti i Amnesty International për vitin 2022/2023: <https://www.amnesty.org/en/location/europe-and-central-asia/north-macedonia/report-north-macedonia/>;

Jovanović, I., dhe Angjushiq, A. (2022). *Raport monitorimi për gjuhën e urrejtjes në Serbi*. Instituti i Diversitetit të Medias dhe Instituti i Diversitetit të Medias për Ballkanin Perëndimor. https://www.reportingdiversity.org/wp-content/uploads/2022/07/MRHS_Serbia.pdf;

Raporti i rregullt vjetor i Komisionerit për Mbrojtjen e Barazisë për vitin 2022. <https://ravnopravnost.gov.rs/rs/izvestaji/>;

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut. (2022). Raport për mbrojtjen nga diskriminimi nga pikëpamja e veprimit të Institucionit të Mbrojtjesit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi: https://www.ombudsman.co.me/docs/1672090896_polugodis--nji%20izvjes--that%20o%20zas--titi%20od%20discriminacije_21122022.pdf

⁽²¹⁾ Hërvatin, S. B., Petković, B., dhe Hoxhiq, S. (2021). *Narrivat e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Pasqyrë rajonale*. Instituti i Paqes dhe SEENPM. <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2021/03/Regional-overview-Resilience-research-2.pdf> (fq. 22)

⁽²²⁾ Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32000L0043&from=EN>

⁽²³⁾ Rreth organeve të barazisë shihni më shumë këtu: https://commission.europa.eu/strategji-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/tackling-discrimination/equality-bodies_en

ato në përputhje me ligjet në fuqi; të vendosin nëse ka pasur shkelje të ligjit; të marrin vendime ligjërish të detyrueshme që kërkojnë masa për të ndaluar sjelljen e padisiplinuar dhe të vendosin sanksione; dhe të sigurojnë ekzekutimin dhe zbatimin e vendimeve të tyre dhe publikimin e vendimeve dhe rekomandimeve të tyre. Organet e barazisë që janë të llojit promovues japin rekomandime jodetyruese që kërkojnë masa për të ndaluar sjelljen e padisiplinuar; ato sigurojnë zbatimin e rekomandimeve të tyre dhe, kur është e përshtatshme, i publikojnë vendimet e tyre. Aktualisht, nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së kërkohej të krijonin organe kombëtare të barazisë, dhe megjithëse vendet e BP-së nuk janë anëtare të BE-së, në këtë drejtim ato vepruan në mënyrë proaktive. Prandaj, në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi ka organe të themeluara të barazisë me atribute të një tribunali, dhe në Bosnje dhe Hercegovinë (BdheH), Kosovë⁽²⁴⁾ dhe Mali i Zi organet e barazisë janë të llojit promovues (kompetenca për barazi u është dhënë institucioneve vendase të Avokatit të popullit që mund të kryejë monitorim dhe të iniciojë procedura kundërvajtëse).

- Agjencitë rregullatore të medias
 - Të gjitha vendet kanë krijuar agjenci të pavarura rregullatore për mediat që e mbikëqyrin monitorimin e transmetuesve tradicional të medias (radio dhe TV), si dhe shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale. Në disa vende, si Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, këto organe janë gjithashtu përgjegjëse për monitorimin e mediave të shkruara. Këto agjenci kanë bazë ligjore për të vepruar ndaj ankesave për gjuhën e urrejtjes me lloje të ndryshme sanksionesh që mund t'ua vendosin mediave. Pothuajse të gjitha ato mund të vendosin masat e paralajmërimit ose të revokimit, ose të paktën të pezullojnë përkohësisht licencat dhe të ndalojnë publikimin (ose transmetimin). Tre rregullatorë (BdheH, Kosovë, Mali i Zi) mund të veprojnë sipas detyrave të tyre zyrtare kur bëhet fjalë për ankesat, e disa mund të vendosin gjoba (Shqipëri, BdheH, Kosovë). Rregullatorët në BdheH, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi mund t'i publikojnë vendimet e tyre në faqet e tyre të internetit ose në raportet vjetore.
- Mekanizmat vetë-rregullues të medias
 - Këta mekanizma mund të veprojnë si ndërmjetës, ata zakonisht marrin vendime dhe në disa raste mund të urdhërojnë korrigjimin ose heqjen e përmbajtjes ose publikimin e kërkimit të faljes. Vendimet e tyre nuk janë ligjërish të detyrueshme dhe ata nuk mund të vendosin sanksione, por mund t'i publikojnë vendimet e tyre, në varësi të vendit ku janë të krijuara nëpërmjet Kodit të Etikës të miratuar nga Shoqata e Gazetarëve (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Serbi), Kodit për shtypin dhe mediat online (BdheH) dhe Kodit të Gazetarëve (Mali i Zi).
- Komisionet Qendrore të Zgjedhjeve
 - Këto komisione kanë mandat të monitorojnë fushatat zgjedhore dhe mund të sanksionojnë kandidatët që përdorin gjuhën e urrejtjes. Me ndryshime në emër (Komisionet Qendrore të Zgjedhjeve: Shqipëri, BdheH dhe Kosovë; Komisionet Shtetërore të Zgjedhjeve: Mali i Zi dhe Maqedoni e Veriut; dhe Komisionet Republikane të Zgjedhjeve: Serbi), ato ekzistojnë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Për shembull, Komisionet Qendrore të Zgjedhjeve të BdheH, sipas Ligjit Zgjedhor të BdheH, mund të vendosin gjoba dhe heqjen nga lista e kandidatëve të subjekteve politike që përdorin gjuhën e urrejtjes gjatë fushatave zgjedhore. Duke e ndjekur mekanizmin ekzistues, Komisionet Qendrore të Zgjedhjeve të BdheH në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2022 vendosën një gjobë në vlerë prej 3000 BAM për partinë politike Lëvizja e Veprimit Demokratik të BdheH (PDA) dhe një gjobë në vlerë prej 5000 BAM për kandidaten e PDA-së Elzina Piriq për përdorimin e gjuhës së urrejtjes në një tubim politik në Aljkoviqi - Komuna e Banoviqit.

⁽²⁴⁾ Ky kategorizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin, dhe është në përputhje me RKS KB 1244 dhe Mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësis së Kosovës.

Por, përveç ekzistencës dhe përpjekjeve të këtyre organeve, gjuha e urrejtjes në BP është ende e përhapur. Kohët e fundit ka pasur një njohje në rritje të mënyrave të shumta përmes të cilave OSHC-të mund të mbështesin parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe efektet e saj shkatërruese.

OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm në kuptimin dhe reagimin ndaj gjuhës së urrejtjes. Shumë OSHC kanë njohuri dhe kuptim unik të konteksteve lokale dhe të sfidave me të cilat përballen individët dhe grupet në rrezik të viktimizimit nga gjuha e urrejtjes dhe nevojat e atyre që preken nga gjuha e urrejtjes. Partneritetet ndërmjet agjencive të përmendura më parë dhe OSHC-ve mundësojnë që përgjigjet të përshtaten për çdo rast individual, mund të mbështesin punën operacionale dhe, mbi të gjitha, të ndihmojnë në ndërtimin e sigurisë dhe besimit të autoritetet. Një shembull i mirë i kësaj praktike mund të gjendet në bashkëpunimin dhe partneritetin e Qendrës së Hapur të Sarajevës dhe disa prokurorive në B dhe H⁽²⁵⁾. Nëpërmjet këtij partneriteti në disa Prokurori në B dhe H, u emërua një person kontaktues i cili do të punojë drejtpërdrejt me personat LGBTQI+, viktimë e krimeve të kryera nga urrejtja (duke përfshirë gjuhën e urrejtjes). Ndonëse çdo qytetari në B dhe H i garantohet ligjërisht mbrojtja kundër dhunës, me caktimin e një personi kontaktues, do të mundësohet qasje e drejtpërdrejtë tek bartësi i funksionit gjyqësor, i cili është i sensibilizuar dhe mbi të gjitha i trajnuar për të punuar me personat LGBTQI+. Më tej, përmes këtij bashkëpunimi, trajnimet për krimin e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes bëhen module të rregullta të trajnimeve edukative që u ofrohen prokurorëve dhe gjyqtarëve nga qendrat për edukimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në përgjithësi, pjesëmarrja aktive dhe kuptimplotë e OSHC-ve mund të sigurojë informacion dhe të kontribuojë për veprime të ndryshme shtetërore për të luftuar gjuhën e urrejtjes.

Roli aktual i OSHC-ve

Roli aktual i OSHC-ve në luftimin e gjuhës së urrejtjes është kryesisht në parandalimin dhe zbulimin, ndërsa shumica e aktorëve institucionalë punojnë në reagimet formale dhe sanksionimin. Prandaj, kombinimi i këtyre angazhimeve mund të përmirësojë përpjekjet aktuale në luftimin e gjuhës së urrejtjes nëpër vendet e BP-së. Aktualisht, OSHC-të janë kryesisht të përfshira në aktivitetet e mëposhtme:

- Monitorimin, regjistrimin, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave:

Organizata më e spikatur në këtë fushë është Zyra e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) që mbledh të dhëna zyrtare dhe të dhënat e raportuara nga OSHC të ndryshme në vendet e synuara⁽²⁶⁾. Disa nga organizatat që regjistrojnë dhe raportojnë incidente që ndodhin në BP janë paraqitur në Tabelën 2.

⁽²⁵⁾ Qendra e Hapur e Sarajevës është një organizatë e shoqërisë civile (OSHC) që punon për të avancuar të drejtat e njeriut, veçanërisht pozitën dhe të drejtat e njeriut të personave dhe grave LGBTI në Bosnje dhe Hercegovinë, përmes përfaqësimit të realiteteve të tyre dhe avokimit për ndryshime ligjore, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në të gjitha fushat e jetës. Shih më shumë këtu: <https://soc.ba/en/about-us/>

⁽²⁶⁾ OSBE/ODIHR-i mbledh të dhëna për krimin e urrejtjes, gjuhën e urrejtjes dhe nxitjen e urrejtjes. Shih më shumë këtu: <https://hatecrime.osce.org/index.php/hate-crime-data>

Tabela 2: OSHC-të që regjistrojnë dhe raportojnë incidente të gjuhës së urrejtjes

Shteti	OShC-ja	Aktivitetet
Shqipëri	Forumi Musliman i Shqipërisë ⁽²⁷⁾	Regjistrimi dhe raportimi i incidenteve
BdheH	Qendra për Arsim dhe Huluntim Nahla ⁽²⁸⁾	Regjistrimi dhe raportimi i incidenteve
BdheH	Qendra e Hapur e Sarajevës	Regjistrimi dhe raportimi i incidenteve
Mali i Zi	Forumi LGBT Progres ⁽²⁹⁾	Regjistrimi dhe raportimi i incidenteve
Maqedoni e Veriut	Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë ⁽³⁰⁾	Regjistrimi dhe raportimi i incidenteve
Serbi	Federata e Komuniteteve Hebraike të Serbisë (SJOS) ⁽³¹⁾	Regjistrimi dhe raportimi i incidenteve
Serbi	Shoqata "Da se zna"! ("Të dihet") ⁽³²⁾	Regjistrimi dhe raportimi i incidenteve
Kosovë	Kosovo 2.0 ⁽³³⁾	Regjistrimi dhe raportimi i incidenteve

Këto organizata e monitorojnë shfaqjen e gjuhës së urrejtjes kundër karakteristikave të mbrojtura që janë në fokus të punës së tyre (përkatësia etnike, kombësia, feja, orientimi seksual, gjinia, etj.) ⁽³⁴⁾. Ato i mbledhin dhe i regjistrojnë ato të dhëna dhe i raportojnë ato tek institucione të ndryshme. Disa OShC raportojnë incidente tek aktorët institucionalë të diskutuar më parë dhe/ose tek organet e tjera që mbledhin të dhëna në një nivel më të gjerë, siç është për shembull OSBE/ODIHR-i. Disa prej tyre gjithashtu publikojnë raporte periodike për incidentet e zbuluara dhe të regjistruara dhe/ose bëjnë ndjekje të rasteve të raportuara në polici ose te aktorë të tjerë institucionalë përkatës.

Përveç OSBE/ODIHR-it që mbledh të dhëna për 57 shtete pjesëmarrëse (duke përfshirë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përveç Kosovës), ka OShC që i kryejnë këto aktivitete në nivel të vende të BP-së. Shembulli i mbledhjes së të dhënave brenda vendeve të BP-së mund të gjendet në punën e Rrjeti të Raportimit të Diversitetit 2.0 që mbledh të dhëna mbi diskursin e urrejtjes dhe të diskriminimit në mjedisin mediatik nëpërmjet OShC-ve kombëtare ⁽³⁵⁾ dhe në punën e "You are Heard": Ballkani Perëndimor dhe Turqia, që mbledh të dhëna për incidentet anti-LGBTQI+, të tilla si ngacmimet, dhuna dhe gjuha e urrejtjes në të gjithë e vendet e BP-së dhe në Turqi ⁽³⁶⁾.

Lidhur me këtë pjesë të aktiviteteve të OShC-ve, mangësi mund të ndodhin në kuadrin metodologjik që ato e përdorin për monitorimin, regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave. Shumica e OShC-ve kanë zhvilluar

⁽²⁷⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://forumimusliman.org/english/>

⁽²⁸⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://nahla.ba/>

⁽²⁹⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://lgbtprogres.me/>

⁽³⁰⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <http://www.mhc.org.mk>

⁽³¹⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://www.savezjos.org/en/>

⁽³²⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://dasezna.lgbt/en/who-we-are/>

⁽³³⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://kosovotwopointzero.com/en/about-us/>

⁽³⁴⁾ Kjo nuk është një listë e plotë e OShC-ve që punojnë në këtë fushë.

⁽³⁵⁾ Ata gjithashtu e publikojnë Raportin e tyre të monitorimit mbi gjuhën e urrejtjes në çdo vend, si dhe Pikat kryesore të monitorimit mujor për të gjitha vendet e BP-së.

⁽³⁶⁾ Shih më shumë në seksionin "Rekomandime".

metodologjinë e tyre që nuk është domosdoshmërisht në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues në këtë fushë dhe për këtë arsye ato të dhëna nuk mund të përdoren me kapacitet të plotë (për hartimin, raportimin, analizën e rasteve të zbuluara kundrejt atyre të ndjekura penalisht, etj.). Për më tepër, një metodologji e zhvilluar individualisht nuk mundëson krahasimin e të dhënave të regjistruara brenda vendit ose rajonit të BP-së.

- Edukimi dhe ndërgjegjësimi:

Një numër i caktuar i OSHC-ve kryejnë një larmi aktiviteteve edukative në forma të ndryshme dhe me audiencë të ndryshme të synuara në varësi të fushëveprimit të punës së tyre. Këto praktika, për shembull, mund të shihen në punën e organizatave të paraqitura në Tabelën 3.

Tabela 3: Shembuj të aktiviteteve edukative të OSHC-ve

Shteti	OSHC-ja	Aktivitetet
Maqedoni e Veriut	Fondacioni Metamorfozis ⁽³⁷⁾	Ka realizuar një sërë trajnimesh për trajtimin e gjuhës së urrejtjes në media
Mali i Zi	Forumi MNE ⁽³⁸⁾	Ka realizuar trajnimin në temën "Luftimi i gjuhës së urrejtjes në internet"
Kosovë	Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim ⁽³⁹⁾	Ka realizuar një seri trajnimesh për studentë, OSHC dhe aktivistë të të drejtave të njeriut
Kosovë	Kosova Young Lawyers (KYL) ⁽⁴⁰⁾	Në kuadër të projektit 'MENDO! Mos Urre', ata kanë zhvilluar qasje formale dhe joformale edukative që janë publikuar në internet në një formë interaktive dhe janë të disponueshme për të gjithë njerëzit që dëshirojnë t'i bashkohen luftës kundër urrejtjes në internet, lajmeve të rreme dhe dezinformimit
Serbi	Libero ⁽⁴¹⁾	Mbajti një edukim për nxënësit e shkollave të mesme
BdheH	Perpetuum Mobile: Instituti për Rininë dhe Zhvillimin e Komunitetit ⁽⁴²⁾	Ka zhvilluar trajnime për politikanët me qëllim parandalimin e gjuhës së urrejtjes në fushatat politike

Këto aktivitete edukative përdoren shpesh si një mjet për rritjen e ndërgjegjësit, por ndonjëherë OSHC-të zhvillojnë forma të ndryshme aktiviteteve vetëm me qëllim të rritjes së ndërgjegjësit, si "Rinia për Paqe" (BdheH)⁽⁴³⁾ që, në partneritet me Qendrën Edukative të Somborit (Serbi)⁽⁴⁴⁾ dhe "Udhëtim i Lirë" (Shqipëri)⁽⁴⁵⁾, e kanë zbatuar fushatën #ALTerHate brenda platformës #Speech4Change që synon të luftojë gjuhën e urrejtjes përmes aktiviteteve të edukimit, sensibilizimit dhe avokimit për pranimin e diversitetit dhe përfshirjes përmes krijimit të narrativave alternative. Disa OSHC, të tilla si Iniciativat Qytetare (Serbi)⁽⁴⁶⁾, po rrisin ndërgjegjësimin duke publikuar shënime për dënimin e gjuhës së zbuluar të urrejtjes, ndërsa disa, si

⁽³⁷⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://metamorphosis.org.mk/en/>

⁽³⁸⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://www.forum-mne.com/>

⁽³⁹⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://advocacy-center.org/>

⁽⁴⁰⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://kyl-kos.org/>

⁽⁴¹⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://libero.org.rs/>

⁽⁴²⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://www.pm.rs.ba/about-us/>

⁽⁴³⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://www.youth-for-peace.ba/en/>

⁽⁴⁴⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://sec.org.rs/>

⁽⁴⁵⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://udhetimiilire.org/en/>

⁽⁴⁶⁾ Për OSHC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://www.gradjanske.org/en/about-us/>

CIVIL (Maqedoni e Veriut) ⁽⁴⁷⁾, organizojnë ngjarje publike dhe promovojnë botime të ngjashme. Rritja e ndërgjegjësimit ndonjëherë arrihet duke organizuar tryeza të rrumbullakëta me temën e gjuhës së urrejtjes dhe duke i transmetuar ato, p.sh. Demokracia për Zhvillim (Kosovë) ⁽⁴⁸⁾.

Sa i përket edukimit, problemet lidhen me çështjen e qëndrueshmërisë. Aktivitetet edukative shpesh lidhen me projektet e veçanta të OShC-ve që kanë një kohëzgjatje të caktuar dhe për këtë arsye ato kanë shtrirje të kufizuara. Nga ana tjetër, aktivitetet ndërgjegjësuese, në varësi të mjetit praktik që përdorin, kanë shpërndarje dhe qëndrueshmëri më të madhe.

- Hulumtimet:

OSHC-të gjithashtu bëjnë hulumtime të ndryshme në këtë fushë që mund të jenë një bazë e dobishme dhe të ndihmojnë në luftimin e gjuhës së urrejtjes. Rezultatet e këtyre nismave hulumtuese, në varësi të temës, përdoren për edukimin e publikut, për të rritur ndërgjegjësimin, për të vënë në pikëpyetje efikasitetin e kornizave ligjore, për të zbuluar faktorët nxitës, etj. Disa mangësi në punën e OShC-ve në këtë fushë lidhen me mungesën e vazhdimësisë kohore dhe territoriale. Shembuj të punës së OShC-ve në këtë fushë janë paraqitur në Tabelën 4.

Tabela 4: Shembuj të aktiviteteve hulumtuese të OShC-ve

Shteti	OSHC-ja	Aktivitetet
Serbi	Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut ⁽⁴⁹⁾	Hulumtim i publikuar mbi mekanizmat e mbrojtjes nga gjuha e urrejtjes në internet
Serbi	Qendra për Profesionalizimin e Medias dhe Edukimin Mediatik (CEPROM) ⁽⁵⁰⁾	Ka kryer hulumtime për praninë e gjuhës së urrejtjes në media dhe në internet
Mali i Zi	Forumi LGBT Progres ⁽⁵¹⁾	Ka kryer dhe publikuar hulumtime mbi praktikën policore dhe gjyqësore në rastet e dhunës dhe gjuhës së urrejtjes ndaj personave LGBTQI+
BdheH	Iniciativa Atlantike: Qendra për Hulumtime të Sigurisë dhe Drejtësisë ⁽⁵²⁾	Ka kryer dhe publikuar hulumtime mbi mekanizmat ligjorë dhe institucionalë të mbrojtjes nga gjuha e urrejtjes dhe aktualisht është duke kryer hulumtime mbi praktikën gjyqësore në ndjekjen penale të nxitjes së urrejtjes në BdheH në 10 vitet e fundit.
Maqedoni e Veriut	CIVIL ⁽⁵³⁾	Ka kryer dhe publikuar hulumtime për gjuhën e urrejtjes në proceset politike dhe zgjedhore

⁽⁴⁷⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://www.civil.org.mk/>

⁽⁴⁸⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://d4d-ks.org/en/mission-and-vision/>

⁽⁴⁹⁾ Stojković, M., dhe Pokushevski, D. (2018). *Urrejtja anonime: Mekanizmat e mbrojtjes nga gjuha e urrejtjes në internet*. Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut.

⁽⁵⁰⁾ CEPROM. (2019). *Agresioni komunikues në Serbi 2019*. CEPROM.

⁽⁵¹⁾ Zeković, A. S., Kojić, J., dhe Tomović, P. (2014). *Mitet dhe stereotipet - Dhuna dhe gjuha e urrejtjes kundër personave LGBT: Praktika policore dhe gjyqësore në Mal të Zi*. Forumi LGBT Progres ()

⁽⁵²⁾ Halilović, H., dhe Luçiq-Çatiq, M. (2022). *Krimet e urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes, si t'i njohim dhe t'i procedojmë në mënyrë adekuate - doracak për gjyqtarët dhe prokurorët*. Iniciativa Atlantike.

⁽⁵³⁾ CIVIL. (2022). *Zgjedhjet nën një breshëri të dezinformave dhe gjuhës së urrejtjes: zgjedhjet lokale*. Civil - Qendra për Liri.

- Ndhima dhe mbështetja e viktimave:

Mënyrat më të zakonshme në të cilat OShC-të i ndihmojnë dhe/ose i mbështesin viktimat e gjuhës së urrejtjes në përgjithësi dhe në praktikën e OShC-ve të BP-së janë ndihma/këshillimi psikologjik falas dhe ndihma juridike falas. Problemi i mundshëm që shfaqet në këtë fushë është çështja e financimit. Në fakt, nëse aktiviteti nuk lidhet me financimin bazë, por me një projekt specifik, qëndrueshmëria e ndihmës dhe mbështetjes së ofruar mund të jetë thjesht e përkohshme. Për më tepër, shpërndarja e informacionit në lidhje me ndihmën e disponueshme mund të jetë një problem. Shembuj të punës së OShC-ve në fushën e ndihmës dhe mbështetjes së viktimave janë paraqitur në Tabelën 5.

Tabela 5: Shembuj të aktiviteteve të OShC-ve në lidhje me ndihmën dhe mbështetjen e viktimave

Shteti	OSHC-ja	Aktivitetet
BdheH	Qendra e Hapur e Sarajevës	Ndihmë/këshillim psikologjik dhe ndihmë juridike
BdheH	Shoqata "Okvir" ⁽⁵⁴⁾	Këshillim psikologjik për personat LGBTQI+
Serbi	Komiteti i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut (YUCOM)	Ndihmë juridike
Mali i Zi	Qendra Juridike ⁽⁵⁵⁾	Ndihmë juridike
Maqedoni e Veriut	Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë	Ndihmë juridike

Si të përmirësohen praktikat ekzistuese

Deri më tani, siç ka treguar analiza e mëparshme, ekzistojnë disa kufizime lidhur me punën e OSHC-ve dhe zgjidhjet për tejkalimin e mangësive të konstatuara.

- Monitorimi, regjistrimi, mbledhja dhe raportimi i të dhënave:

Vështrime mbi praninë dhe njohuritë mbi shtrirjen e fenomenit janë hapi i parë në krijimin e një përgjigjeje adekuate. OSHC-të, ndryshe nga aktorët institucionalë, kanë një pozicion unik në këtë detyrë, pasi ato shpesh kanë më shumë kapacitet për monitorim, viktimat kanë më shumë besim tek OSHC-të dhe kanë më shumë gjasa t'i raportojnë rastet e tyre tek një OShC, se sa tek një organ formal, ata mund të bashkëpunojnë dhe të ndajnë të dhëna pa ngarkesën e burokracisë dhe të procedurave formale, etj. Prandaj, për të arritur vlerën maksimale të aktiviteteve të tyre, OSHC-të duhet të kenë parasysh sa vijon:

- Në varësi të grupit/grupeve të synuara që i ndjekin OSHC-të (LGBTQI+, refugjatët, romët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, migrantët, etj.) dhe fushat specifike të interesit (gjuha e urrejtjes në diskursin politik, gjuha e urrejtjes në median e shkruar, etj.), të përdorin/zhvillojnë një kornizë për mbledhjen e të dhënave që rrjedh nga kuadri ligjor kombëtar.

⁽⁵⁴⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <http://www.okvir.org/o-nama/>

⁽⁵⁵⁾ Për OShC-në dhe aktivitetet e saj, shihni më shumë këtu: <https://pravnicentar.co.me/>

- Për të rritur krahasueshmërinë dhe përputhshmërinë e të dhënave, të përdorin metodologjinë e zhvilluar nga aktorët institucionalë (nëse ekziston) ose metodologjinë e zhvilluar nga OShC të tjera.
 - Për të rritur ndikimin e ndarjes së të dhënave, t'i përafrojnë përkufizimet dhe metodat e mbledhjes së të dhënave me OSHC-të që punojnë me grup(e) të ngjashme të synuara dhe fusha të ngjashme të interesit.
 - Të ndajnë metodologjitë e mbledhjes së të dhënave dhe të krijojnë një sistem për shkëmbimin e rregullt të informacionit.
- Edukimi:

Problemi kryesor në këtë pjesë të punës së OSHC-ve është çështja e qëndrueshmërisë dhe e shtrirjes së programeve edukative. Edhe pse çdo aktivitet edukativ çoi në një ndryshim duke pasur parasysh kostot dhe kompleksitetin e krijimit të aktiviteteve edukative, duhet të sigurohet përdorimi afatgjatë dhe vetë-qëndrueshmëria kur është e mundur. Për ta arritur këtë, OSHC-të duhet të kenë parasysh sa vijon:

- Të krijojnë dhe të avokojnë për përfshirjen e paketave edukative në arsimin formal (për praktikuesit, në kurrikulat e shkollave, në kurrikulat e universiteteve, etj.).
 - Të përfshijnë edukimin për të drejtat e njeriut në arsimin formal (për praktikuesit, në kurrikulat e shkollave, në kurrikulat e universiteteve, etj.).
 - Të përfshijnë paketat edukative në forumet publike dhe fushatat ekzistuese, konferencat, filmat dhe videot, ekspozitat dhe muzetë, sportet dhe ngjarjet sportive, aktivitetet e komunitetit, etj.
 - Të përdorin teknologjinë (fushata edukative në mediat sociale, mjete online falas, mjete edukative ndërvepruese, etj.).
- Ndhurma dhe mbështetja e viktimave:

Shumica e informacionit rreth OSHC-ve mund të gjendet vetëm nëpërmjet internetit, gjë që lë shumë njerëz që kanë nevojë për ndihmë në një pozicion të pafavorizuar dhe pa informacion rreth ndihmës që mund ta marrin për shkak të pranisë së kufizuar të internetit në pjesë të caktuara të BP-së dhe mungesës së edukimit digjital. Për të tejkaluar këtë problem, OSHC-të duhet ta bëjnë më të dukshëm informacionin për ndihmën e disponueshme duke përdorur mediat tradicionale (radiot, televizionet, mediat e shkruara, posterat në vende të rëndësishme, fletëpalosjet, etj.).

Çfarë tjetër mund të bëjnë OSHC-të?

Përveç aktiviteteve në të cilat OShC-të janë përfshirë tashmë, në varësi të portofolit të tyre, kontributi i tyre mund të zgjerohet edhe në aktivitetet e mëposhtme:

Raportimi duhet të përmirësohet duke i fuqizuar ata që preken nga gjuha e urrejtjes dhe dëshmitarët të flasin pa ngurrim, si dhe nëpërmjet **raportimit nga palë të treta**. Raportimi nga palët e treta është procesi në të cilin një viktimë ose dëshmitar raporton një gjuhë të mundshme urrejtjeje te një OSHC. Kjo OSHC pastaj e raporton gjuhën e urrejtjes tek organi zyrtar përkatës. Që raportimi nga palët e treta të jetë efektiv, OSHC-të duhet të harmonizojnë përkufizimet dhe metodologjitë e mbledhjes së të dhënave, të sigurojnë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe të vërtetojnë se i gjithë personeli i përfshirë është i kualifikuar dhe i trajnuar në mënyrë adekuate. Kur është e mundur, rekomandohet që ato angazhime të zyrtarizohen përmes marrëveshjeve institucionale.

Duhet të krijohen **bashkëpunime dhe partneritete strukturore**. Ekzistojnë një sërë modelesh për vendosjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit dhe partneriteteve, të tilla si nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit, krijimi i komisioneve dhe grupeve të punës, pjesëmarrja në organet këshillimore ose të ekspertëve, emërimi i zyrtarëve të specializuar/zyrtarëve të ndërlidhjes me komunitetin/kontakteve për gjuhën e urrejtjes në nivel rajonal ose lokal, caktimi i përfaqësuesve të OSHC-ve për të bashkëpunuar me policinë dhe organet e tjera formale, etj. Një bashkëpunim dhe partneritet i tillë në asnjë moment nuk duhet të ndikojë në rolin e pavarur të OSHC-ve.

Praktika e mirë përkatëse në BE

Lidhur me mësimet e nxjerra nga BE-ja që mund të ndihmojnë dhe mbështesin praktikuesit në BP, një drejtim i mirë veprimi mund të gjendet në punën e Grupit të Nivelit të Lartë të BE-së për luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe krimin të urrejtjes. Grupi i Nivelit të Lartë është paramenduar si një platformë për të mbështetur përpjekjet e BE-së dhe ato në nivel kombëtar për të siguruar zbatimin efektiv të rregullave përkatëse dhe për të krijuar politika efektive për të parandaluar dhe luftuar krimin e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes. Kjo bëhet duke nxitur diskutime tematike mbi boshllëqet, sfidat dhe reagimet, duke promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira, duke zhvilluar udhëzime dhe duke forcuar bashkëpunimin dhe sinergjitë ndërmjet palëve kryesore të interesuara. Puna e tyre tashmë ka rezultuar në një sërë mjetesh udhëzuese praktike në fusha kyçe si trajnimi për krimet e urrejtjes, qasja në drejtësi, mbështetja dhe mbrojtja për viktimat e krimin të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, dhe regjistrimi i krimeve të urrejtjes ⁽⁵⁶⁾.

Për më tepër, një çështje e rëndësishme për punën e OSHC-ve është çështja e financimit. Në BE, Komisioni Evropian ofron mbështetje financiare për autoritetet kombëtare dhe OSHC-të që punojnë në gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes, përmes programit Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat (CERV), duke pranuar se OSHC-të luajnë një rol vendimtar në luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe krimin të urrejtjes dhe duke kontribuar kështu në ruajtjen dhe promovimin e të drejtave themelore.

Këto praktika, ndër shumë të tjera në BE, mund të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e ardhshme në BP që mund të prodhojnë veprime të unifikuara në të gjithë BP-në dhe të kenë efekte afatgjata në luftën kundër gjuhës së urrejtjes.

Rekomandime

1. Duhet të krijohet një **rrjet i përbashkët** për narrativat e urrejtjes dhe projektet dhe aktivitetet e gjuhës së urrejtjes në BP, si p.sh. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, "You Are Heard: Ballkani Perëndimor dhe Turqia", dhe Rrjeti i Raportimit të Diversitetit 2.0. Një rrjet i tillë duhet të zhvillojë një metodologji të unifikuar të monitorimit, regjistrimit dhe mbledhjes së të dhënave, programe të edukimit dhe ndërgjegjësimin, si dhe nisma avokuese. Për më tepër, organizatat me përvojë duhet të fuqizojnë OSHC-të lokale dhe të rrisin shkëmbimin e informacionit ndërmjet shteteve të BP-së dhe/ose aktorëve kyç institucionalë.
2. Krijimi i **aleancave strategjike** brenda një shteti dhe/ose rajoni duhet të jetë imperativ. Në fakt, kur është e rëndësishme për kontekstin, OSHC-të duhet të mbështesin mbledhjen e aktorëve kryesorë që do t'i riformulojnë problemet në mënyra që i bëjnë zgjidhjet më të arritshme. Nëse është e mundur, OSHC-të duhet të përdorin ndërmjetësimin dhe ekspertizën e pavarur dhe të ndërtojnë koalicione. Për më tepër, duhet të krijohen/të forcohen partneritetet me palët përkatëse të interesit, duke përfshirë ata që punojnë në industrinë e teknologjisë. Shumica e veprimeve kuptimplota kundër gjuhës së urrejtjes nuk do të ndërmerren vetëm nga OSHC-të, por nga qeveritë (duke përfshirë autoritetet rajonale), kompanitë private, mediat dhe aktorët fetarë dhe të tjerë.

⁽⁵⁶⁾ 2022 [Parimet kryesore udhëzuese për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe organizatave të shoqërisë civile](#) janë një shembull i udhëzimeve të prodhuara nga Grupi i Nivelit të Lartë.

3. Krijimi i **bashkëpunimit strukturor dhe i partneriteteve me aktorët përkatës institucionalë** është një hap shumë i rëndësishëm në luftimin e gjuhës së urrejtjes në nivel shtetëror, duke pasur parasysh se një bashkëpunim dhe partneritet i tillë nuk duhet të cenojë rolin e pavarur të OSHC-ve. Në fakt, të gjitha aktivitetet e OShC-ve në parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes mund të sjellin përparësi të shumta nëse kombinohen dhe plotësohen me punën e aktorëve institucionalë. Aktorët institucionalë mund të përfitojnë nga informacioni, njohuritë dhe aktivitetet e ndërmarra nga OSHC-të në fushën e monitorimit, regjistrimit dhe mbledhjes së të dhënave, edukimit dhe aktiviteteve të avokimit. Në fakt, një përgjigje adekuate dhe gjithëpërfshirëse ndaj shfaqjes së gjuhës së urrejtjes kërkon kuptim të plotë të dinamikës së kësaj dukurie. Meqenëse, në disa raste, aktorët institucionalë nuk kanë kapacitet për (nuk është në fushëveprimin e tyre të punës) një qasje gjithëpërfshirëse, mund të jetë i dobishëm kombinimi i gjetjeve të OSHC-ve.
4. Përveç faktorëve organizativë, **theksi më i madh duhet t'i kushtohet arsimit**. Arsimi mund të jetë baza për të luftuar intolerancën dhe diskriminimin, për rritjen e ndërgjegjësimit, adresimin e shkaqeve rrënjësore të gjuhës së urrejtjes dhe avancimin e përfshirjes dhe bashkëjetesës paqësore. Përpjekjet duhet të drejtohen në përfshirjen e kurrikulave arsimore në programet arsimore formale gjë që do të sigurojë qëndrueshmëri. Gjithashtu, iniciativat joformale, si edukimi i personelit të aktorëve institucionalë dhe i personelit të lidhur me median, rinisë, etj., janë të mirëseardhura dhe mund të plotësojnë arsimin e detyrueshëm duke e plotësuar çdo mangësi. Në fakt, zhvillimi i sjelljes së përgjegjshme, angazhimi qytetar, aftësitë e të menduarit kritik dhe edukimi mediatik mund të nxisin rritjen e vlerave të të avancuara pozitive të mirëkuptimit dhe respektit reciprok për të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe diversitetin njerëzor në të gjithë BP-në.
5. Ekziston nevoja për më shumë **hulumtime empirike** mbi gjuhën e urrejtjes në BP dhe lidhjet e saj specifike lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Një hulumtim i tillë do të mundësojë kuptim më të mirë të faktorëve dhe aktorëve që çojnë në gjuhën e urrejtjes në sfera të ndryshme të shoqërisë, sensibilizimin e komunitetit profesional dhe publikut, si dhe sinjalizimin e kërcënimeve të mundshme të sigurisë dhe përshkallëzimit. Rezultatet e të gjitha hulumtimeve dhe rekomandimet e lidhura me to duhet të jenë të disponueshme për publikun dhe t'u dorëzohen palëve përkatëse lokale, rajonale dhe/ose ndërkombëtare.

Bibliografia

Council of Europe. (2022). *Hate crime and hate speech*. Thematic factsheet, Department for the Execution of Judgments of the European Court of Human Rights. <https://rm.coe.int/thematic-factsheet-hate-crime-eng-docx/1680a96865>

Petković, B., Hrvatinić, S. B., Hodžić, S., Londo, I., Sokol, A., Hoxha, A., Sylva, M., Bogdanović, M., Nikodinoska, V., Jovović, J., Valić Nedeljković, D., & Aydınli, S. (2021). *Hate narratives in the Western Balkans and Turkey*. RESILIENCE: For Media Free of Hate and Disinformation, Peace Institute, Ljubljana and SEENPM, Tirana. <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2021/04/Resilience-E-book-research-2-all-reports-with-CIP-April-2021.pdf>

Radicalisation Awareness Network. (2023). *Confronting hate speech in the Western Balkans*.

Radicalisation Awareness Network. (2022). *Lessons learned from alternative narrative campaigns*. https://home-affairs.ec.europa.eu/whats-new/publications/lessons-learned-alternative-narrative-campaigns-march-2022_en

Për autoren:

Marija Luçiq-Çatiq është profesoreshë në Fakultetin e Kriminalistikës, Kriminologjisë dhe Studimeve të Sigurisë të Universitetit të Sarajevës (Bosnje dhe Hercegovinë). Fusha kryesore e saj e interesit është lufta kundër krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes. Ajo aktualisht është duke punuar për OShC të ndryshme si studiuese, avokuese dhe edukatore në fushën e krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes.

GJETJA E INFORMACIONIT RRETH BE-së

Online

Të dhëna lidhur me Bashkimin Evropian në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së ka në ueb-faqen Europa në: https://europa.eu/european-union/index_en

Publikimet e BE-së

Mund të shkarkoni ose të porositni publikime të BE-së falas dhe me pagesë nga: <https://op.europa.eu/en/publications>. Shumë kopje të publikimeve falas mund të gjenden duke kontaktur Europe Direct ose qendrën tuaj lokale të informimit (shih https://europa.eu/european-union/contact_en).

Ligjet e BE-së dhe dokumentet përkatëse

Për qasje në të dhëna ligjore nga BE-ja, duke përfshirë të gjitha ligjet e BE-së që nga viti 1952 në të gjitha versionet në gjuhët zyrtare, shkoni në EUR-Lex në: <http://eur-lex.europa.eu>

Të dhëna të hapura nga BE-ja

Portali i të dhënave të hapura të BE-së (<http://data.europa.eu/euodp/en>) siguron qasje në grupet e të dhënave nga BE-ja. Të dhënat mund të shkarkohen dhe ripërdoren falas, për qëllime komerciale dhe jokomerciale.

Radicalisation Awareness Network

RANI

Practitioners



Publications Office
of the European Union